

**ESE**

TEMA :

**PARIMI I BARAZISE DHE MOSDISKRIMINIMIT.**

**GARANCITE LIGJORE ( KUADRI LIGJOR NE SHQIPERI )**

**DHE INSTITUCIONET GARANTUESE PER MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI.**

**PUNOI : XHON SKENDERI**

GRUPI 3  
FAKULTETI I DREJTESISE  
UNIVERSITETI I TIRANES

TIRANE , ME 19.04.2013

## **Abstrakt**

Ky punim synon krijimin e një kuptimi sa më real të zbatimit të parimeve dhe normave për mosdiskriminimin.

Punimi trajton në mënyrë sintetike çështjet e mosdiskriminimit si në aspektin ndërkombëtar ashtu edhe atë vendor, si në aspektin historik ashtu edhe atë aktual me qëllim relaizimin e harmonizuar të një kontrasti evidentues të fakteve, ngjyrjeve dhe veprimeve sipas etapave dhe ecurisë së proceseve reformuese për zbatimin e parimeve dhe ligjshmërisë.

Ky punim ka si qëllim dhënien e një kontributi minimal për zbatimin e parimit të mosdiskriminimit në Shqipëri, duke parë që natyra diskriminuese e shoqërisë shqiptare ende vazhdon të bëhet përcaktuese e politikave diskriminuese.

Megjithatë hapat pozitivë që ka bërë Shqipëria në krijimin e një kuadri ligjor për këtë qëllim, punimi mund të ndihmojë për rishikimin e legjislacionit si dhe hartimin e akteve nënligjore, që ende mungojnë ose janë të paplota, dhe që bejnë të pamundur zbatimin në praktike të ligjeve.

Të drejtat e njeriut janë të lidhura me ekzistencën e natyrës njerëzore. Ato nuk derivojnë nga shteti por nga vetë qenia njerëzore. Ato lindin bashkë me ne. Si të tilla ato nuk dhurohen apo jepen nga shteti, por shteti, është i detyruar t'i garantojë ato. Të drejtat e njeriut janë parime në bazë të të cilave individët mund të veprojnë, të nxjerrin ligje dhe në të njëjtën kohë të gjykojnë e të marrin vendime që mbështeten në to. Por të drejtat e njeriut janë në të njëjtën kohë edhe vlera që shprehin dhe pasqyrojnë dëshirat dhe aspiratat njerëzore. Si vlera, të drejtat e njeriut përfaqësojnë qëllimet dhe idealet më të larta, të cilat, ndonëse të porealizueshme plotësisht, i japin kuptimin jetës shoqërore. Gjatë gjithë historisë së tyre të drejtat e njeriut janë përcaktuar dhe kanë mëshiruar vlerën e dinjitetit të secilit, të lirisë, të barazisë dhe të drejtësisë. Këto vlera janë universale, ato dalin jashtë kornizave të kufijve personalë e kombëtarë<sup>1</sup>. Kulturat dhe shoqëritë janë të ndryshme. Individualiteti i tyre shprehet në forma të larmishme, megjithatë asnjëherë kjo pasuri, kjo ndryshueshmëri nuk ka prekur bazat e patjetërsueshme të të drejtave të njeriut.

Nga kjo pikpamje, çdo individ, pavarësisht nga prejardhja familjare, shoqërore ose kulturore, duhet të pranohet si përfaqësues i gjithë njerëzimit. *Inter alia* dinjiteti njerëzor duhet të pranohet dhe të respektohet nga të gjithë, por jo gjithmonë ndodh kështu ... Këtu merr formë lindja e moszbatimit të një parimi me rëndësi të madhe në tërë lëmet e jurisprudencës: parimi i barazisë. Si një vlerë universale, barazia nënkupton liritë dhe të drejtat e çdo individi: Të tjerët janë të ndryshëm nga unë, por në të njëjtën kohë ne jemi të barabartë, unë e respektoj lirinë e tyre në atë masë që shpall lirinë time. Aftësia ime për të marrë vendime, për të zgjedhur vlerat ose për të marrë pjesë në hartimin e ligjeve, më një fjalë, shkalla e pavarësisë sime varet nga shkalla në të cilën unë përfill njerëzit e tjerë. Pikërisht kjo barazi ndërmjet qenieve njerëzore është pengesa kryesore ndaj diskriminimit për arsye të racës, kombësisë, seksit, fesë dhe gjuhës. Vetëm nëse barazia harmonizohet me lirinë mund të arrihet realisht drejtësia.

Meqë qëniet njerëzore janë të barabarta në të drejta ato duhet të jenë të përgjegjshme për ato veprime që rrezikojnë të mohojnë a të çënojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve. Por përgjegjësia për veprimet mund të kthehet në realitet vetëm në kushtet e ekzistencës së një shoqërie demokratike. Nga ana tjetër, drejtësia shoqërore nënkupton një ndarje të tillë të pasurisë që do të mundësonte më shumë barazi dhe më shumë drejtësi në njohjen e meritave të çdo individi. Ajo përfaqëson një vlerë që i frymëzon njerëzit në veprimtarinë e tyre të përditshme dhe në të njëjtën kohë një ideal për tu arritur nga shtetet dhe individët që janë përgjegjës për fatet e bashkësisë ku jetojnë. Te drejtat e njeriut shtojnë kërkesen për drejtësi si ideal. Ato janë të domosdoshme në jetën e përditshme edhe për ata që nuk e respektojnë ose që e injorojnë barazinë ndërmjet njerëzve dhe mohojnë lirinë e të tjerëve.

Zbatimi i të drejtave të njeriut në jetën e përditshme shtron nevojën e një qëndrimi në të cilin gjykimet e vlerave, gjykimet morale dhe aftësia për të menduar si qytetar të botës luajnë një rol vendimtar. Termi “diskriminim” përdoret për të realizuar trajtimin e padrejtë ose mohimin e privilegjeve normale personave për shkak të racës, seksit, kombësisë ose fesë. Normalisht me të nënkuptohen dallimet që ekzistojnë në trajtim të individëve, të grupeve racore, etnike ose të popujve. Termi vjen nga gjuha latine “dicriminio” dhe ka kuptimin e ndarjes, trajtimit në mënyrë të ndryshme, i kufizimit të të drejtave, ose i vendosjes së pabarazisë. Diskriminimi si një ndër format më të vrazhda të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është mjaft i përhapur dhe bazohet në doktrina të rrezikshme mbi superioritetin ose inferioritetin e racave,

---

1. International Human Rights Law. Oxford, UK: Hart, 2003.

të popujve, gjinive etj. Në bazë të të cilave disa raca kanë vlerë më të vogël dhe kanë nevojë të sundohen nga racat më të vlefshme dhe kjo formë arsyetimi vlen dhe për format e tjera të diskriminimit.

Ligjet e ndryshme që janë në fuqi apo dhe implementimi i tyre, promovimi i shanseve të barabarta, prespektivat dhe kufizimet në raport me diskriminimin janë të huazuara kryesisht nga vendet e zhvilluara perëndimore. Është pothuajse e pashmangshme që në interpretimet e vendimeve gjyqësore të lidhura me këto çështje gjykatësit shqipëtarë të mos i'u referohen jurisprudencës perëndimore. Evolucioni i këtyre vendeve në këtë drejtim nuk mund të kuptohet lehtësisht nga vende si Shqipëria pasi këto ndryshime përfshijnë histori të gjata konstitucionalizmi, të të drejtave civile dhe lëvizjeve feministe, studime intelektuale në realitetin social dhe reflektime të gjata e kritika ndaj institucioneve, pra rruga e Shqipërisë është e gjatë dhe e vështirë, por jo e pamundur ...

Një nga elementët kryesorë të një shteti ligjor janë : kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, barazia përpara ligjit për të gjithë qytetarët pa asnjë dallim, liritë dhe të drejtat e njeriut etj. Shqipëria duke qenë një demokraci relativisht e re legjislativi ekzistues duhet të luajë rolin e tij, por krahas tij duhen dhe masa të tjera siç janë : rritja e ndërgjegjësimit të publikut në çështjet e barazisë, drejtësisë sociale, të drejtave të njeriut, gjinore dhe të drejtat e minoriteteve. Megjithatë duhet kuptuar që, këto ligje nuk kërkojnë thjesht një zbatim mekanik të rregullave formale e abstrakte të tyre kryesisht nga ana e gjykatave, por gjithashtu të jenë të gatshme për t'u perballur me çështje thelbësore politike të lidhura me këto ligje, sepse dihet që ndjeshmëria e publikut ndaj tyre është shumë e madhe. Gjendja e barazisë është e ndryshme në vende të ndryshme.

Barazinë përpara ligjit e garanton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha instrumentat ndërkombëtarë të zbatueshme drejtpërdrejt në Shqipëri. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i është dhënë një vënd mjaft i rëndësishëm dinjitetit njerëzor, duke e kthyer atë në këtë mënyrë në një parim themelor kushtetues. Në mënyrë të veçantë ky parim lidhet me të drejtën e njeriut për të jetuar, me mbrojtjen e integritetit fizik, lirinë personale e të drejtën për një jetë private të qetë etj. Dinjitetit të njeriut, këtij detyrimi, nuk i shëpton dot as Kuvëndi i cili ruan rol thelbësor në nxjerrjen e akteve ligjore mbi afrimin e këtij parimi. Pushteti nuk mund ta privojë njeriun nga e drejta për dinjitet dhe personalitet njerëzor.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon në nenin 15<sup>3</sup> se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik, duke na dhenë një përcaktim të qartë të natyrës së të drejtave të njeriut.

Në të gjithë pjesën e dytë të Kushtetutës trajtohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke afirmuar parime të përgjithshme por dhe shumë lloje të drejtash ( në krerët në vazhdim ).

Nëse shohim kushtetutat e shumë vendeve do dallonim lehtësisht se ato kanë të sanksionuar parimin e barazisë. Ligji 'Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese' e përmbante një parim të tillë : 'Barazia përpara ligjit', Kushtetuta shqiptare e vitit 1998 gjithashtu afirmon parimin e barazisë, në një nga nenet më të rëndësishëm të këtij akti kaq me rëndësi, në nenin 18.

Karakteristikë e Kushtetutës së vitit 1998 është se në formulimin e këtij neni, kufizimi i të drejtës për barazi, është shprehur dukshëm. Këtë gjë mund ta vëmë re që në paragrafin e dytë të këtij neni, përforcohet akoma më tepër në paragrafin e tretë po të këtij neni. Prej kohësh në teorinë konstitucionaliste është bërë një aksiome pohimi se nuk ka të drejta absolute, madje të

---

2. "E drejta kushtetuese", Luan Omari & Aurela Anastasi, Tiranë.

3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

gjitha të drejtat dhe liritë janë të kufizueshme. Në vende të ndryshme ky nen merr formulime të ndryshme, por gjithsesi në bazë të tij qëndrojnë dy elementë substancialë :

- Së pari, qytetarët janë të barabartë para ligjit.

- Së dyti, ndalohen të gjitha privilegjet dhe perfitimet e padrejta.

Pra barazia e afirmuar në këto nene nuk është absolute, njeh dhe ajo kufizimet e saj. Ka shumë arsye pse, që nuk e lejojnë barazinë të jetë absolute. Është Kushtetuta ajo që mund të parashikojë vetë raste të ndryshme që çenojnë barazinë sepse vetë ajo ka parashikuar masa pozitive për kategori të caktuara shoqërore siç janë gratë shtatëzana. Megjithatë jo çdo gjë i është lënë në dorë Kushtetutës pasi ka qënë Gjykata Kushtetuese ajo që ka ndërhyrë me rregullime, pra duke interpretuar Kushtetutën, për të arritur ekuilibrat e duhur. Gjithashtu, ajo ka ushtruar disa kontrolle për të mos lejuar ligje diskriminuese arbitrare ose ligje që krijojnë privilegje të padrejta.

Në fushën e të drejtave të njeriut vendi i normës ndërkombëtare në sistemin hierarkik të normave, paraqet ndryshime nga hierarkia e përgjithshme e normave të parashikuara në nenin 116<sup>4</sup> të Kushtetutës, në nenin 17/2<sup>5</sup> të saj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë me mënyren si është formuluar e ben pjesë integrale Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky nen i cili thekson se ligji që kufizon një të drejtë, në asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut neni (17/2) është një garanci karakteristikë vetëm për Kushtetutën e Shqipërisë. Në botë ka përvoja të ndryshme të statusit që i është dhënë Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përvoja jonë është disi e vecantë<sup>6</sup>, lind nevoja e njohjes më të thellë të raportit që ekziston midis të drejtës së brendshme shqiptare dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Padyshim që Shqipëria bën pjesë në grupin e atyre vendeve që i kanë dhenë KEDNJ-së një fuqi mbiligjore<sup>7</sup> ( neni 122). Kjo do të thotë se nenet e Konventës janë të vendosura mbi ligjet e brendshme por jo mbi Kushtetutën. Por kjo merr një kuptim tjetër nesë lexojmë nenin 17/2 të Kushtetutës sonë, KEDNJ merr një status të barabartë me vetë Kushtetutën. Në këtë mënyrë arrijmë në mënyrë indirekte në përfundimin së të drejtave të parashikuara nga KEDNJ nuk i është kushtuar një status kushtetutor për sa i përket përmbajtjes së tyre, por një status i tillë është parashikuar për kufizimet e këtyre të drejtave.

Është një arritje për legjislacionin shqiptar miratimi i ligjit “ Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi ”. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë barazinë e personave përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, mundësi të barabarta për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë e për të marrë pjesë në jetën publike si dhe mbrojtjen efektive nga diskriminimi e çdo formë tjetër që nxit diskriminimin. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2010, garanton të drejtën e personave për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë në veprimtarinë e tyre të përditshme, për të gëzuar të drejta dhe detyrime të barabarta si dhe për t'u mos diskriminuar padrejtësisht, për asnjë arsye dhe në asnjë mjedis. Ky ligj jep perkufizime të ndryshme por gjithashtu trajton disa nga format e diskriminimit dhe mbrojtjen ndaj tyre. Në jetën e përditshme, ndodh të vihem në rrethana dalluese, përjashtuese ose preferuese, për shkaqe nga më të ndryshmet, përmes sjelljeve të subjekteve të ndryshëm.

---

4. Neni 116

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministr

Mendoj se kuptimi i këtij ligji do të na bëjë të aftë për t'i perballuar këto situata dhe për t'i shmangur ato, duke shfrytëzuar edhe mjetet procedurale që ai ofron. Sanksionimi me ligj i të drejtave të njeriut është mjaft i rëndësishëm, porse më i rëndësishëm është zbatimi në praktikë, i cili bëhet realitet vetëm kur ndërgegjësohemi dhe bindemi që të kërkojmë respektimin e tyre nga institucionet shtetërore, si dhe nga çdo person tjetër, juridik a fizik.

Ky ligj na jep një përcaktim të saktë të diskriminimit e sipas tij diskriminimi është dallimi ose përjashtimi që i bëhet një personi, në raport me të tjerët, në jetën e përditshme, format e diskriminimit mund të jenë të hapura dhe të fshehta, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të kryera me anë të veprimeve ose mosveprimeve.

Ligji parashikon ngritjen e një institucioni shumë të rëndësishëm siç është komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, institucion i pavarur, gjatë ushtrimit të detyrës së tij i nënshtrohet vetëm kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Komisioneri mbështetet nga zyra e tij që përbehet nga personeli dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e misionit të caktuar me ligj. Ai ka disa kompetenca, duke iu referuar nenit 32, mjaft të gjëra dhe nëse ato do të zbatoheshin sic duhet do të kishin një përmirësim të dukshëm në këtë fushë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë afirmon si një parim të përgjithshëm, detyrimin e organeve të pushtetit publik që, në përmbushje të detyrave, të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojë në realizimin e tyre. Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon institucionet përmes të cilëve do të garantohen të drejtat dhe liritë themelore. Disa nene të saj përmbajnë rregulla që krijojnë institucione juridike e juridiksionale autonome me qëllim garantimin në praktikë të të drejtave të shpallura. Ndër këto mund të përmendim:

**1.** Avokatin e popullit, për herë të parë në Kushtetutën e Shqipërisë është krijuar institucioni i obusmanit. Kjo përvojë ka qënë e panjohur për Shqipërinë, deri në fillim të viteve '90-të. Ka pasur ndikim të madh eksperiencia e vendeve skandinave kryesisht por edhe e Zvicrës dhe disa shteteve evropiane të cilat e kanë krijuar menjëherë këtë institucion. Avokati i popullit në përbërje të kompetencave të tij ka zgjidhjen e konflikteve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ashtu sikurse edhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor dhe nga diskriminimi ndaj abuzimeve të administratës publike që le ta pranojmë, statistikisht janë mjaft alarmante.

**2.** Gjykata Kushtetuese, të gjitha format e kontrollit kushtetues ofrojnë garanci reale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Neni 134/2, pika dh, shprehet se Avokati i Popullit mund ta verë në levizje Gjykatën Kushtetuese, pra kjo gjykatë mund të ushtroje të drejtën e saj për kontrollin kushtetues dhe mbi ligje apo akte që mendohet se janë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore. Duke iu referuar vendimit *nr.49 dt. 31.07.2000* të kësaj gjykate, është sqaruar se çdo të quajmë interesa të veta, duke vënë theksin tek të drejtat dhe liritë e njeriut. Në çështje që lidhen me këto të drejta mund të vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese nga Avokati i Popullit.

---

#### 5. Neni 17 :

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

6. Sokol Berberi, Krahasimi I nenit 3 të KEDNJ-se me ligjin dhe praktiken shqiptare, në “ Raportin për studimin e perqasjes së legjisllacionit shqiptar me Konventën Evropiane të të drejtave të Njeriut”, Tirane, qershor, 2003.

**3.** Zhvillimi i normave ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut, ngritja dhe afirmimi i institucioneve dhe procedurave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kanë shënuar edhe një rritje të dukshme të numrit dhe rolit të organizatave jo qeveritare (OJQ) që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Këto organizata janë dy llojesh: kombëtare që veprojnë brenda shteteve të veçanta dhe ndërkombëtare që veprojnë në shkallë rajonale apo universale. Këto organizata kanë ushtruar një ndikim të dukshëm në disa nga etapat kryesore të levizjes për të drejtat e njeriut. Vlen të theksohet se OJQ -të kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë rol në konsolidimin e zhvillimin e sistemit ndërkombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ato kanë qënë faktor i rëndësishëm për funksionimin e tij efektiv. Regjimet, qeveritë apo shoqëritë që janë diskriminuese bëjnë çdo përpjekje që masat anti-diskriminuese të mos realizohen *de facto*. Në këtë moment OJQ-të me angazhimin e tyre konstant japin një kontribut të fuqishëm në këtë fushë duke ecur drejt progresit . Metodrat që ato përdorin në veprimtarinë e tyre varen rast pas rasti, sipas formës së diskriminimit që kanë zgjedhur për veprim. Ato kanë patur një përhapje të madhe dhe sot është vështirë të gjejmë një shtet ku të mos ketë jo një por shumë organizata që merren me të drejtat e njeriut dhe më specifikisht me anti-diskriminimin. Një kategori më vete në fazën aktuale janë dhe OJQ-të që veprojnë brenda territorit të R.SH. Këto OJQ mund ti publikojnë dokumentet lidhur me veprimtarinë e fushave ku ato veprojnë. Ato mund ti afrohen pushtetit lokal, institucioneve të arsimit dhe shëndetësisë, policisë, organeve trajnuese dhe ti këshillojnë për atë se si mund ti shmangen diskriminimit. Të fillojnë me fushata publike për arsimin që të ngrenë vetëdijen për çështjet e diskriminimit dhe ti nxisin që secili të luajë pjesën e tij në krijimin e një shoqërie të drejtë. Të organizojnë seminare dhe takime ndërgjegjësuese për opinionin publik dhe për grupet e prekura për ndonjë çështje konkrete që janë me rëndësi për diskriminimin në vendin tone.

Liria dhe barazia janë dy koncepte unike. Në historinë e mendimit politik ato kanë marrë shpesh drejtime të ndryshme, duke mos ecur në përpjestim të drejtë me njëra-tjetrën. Gjetja e një ekuilibri mes këtyre dy kategorive do të ishte një koncept më i drejtë. Një pikpamje është ajo që i vlerëson ato si standartet bazë pa të cilat njeriu nuk mund të jetojë, një tjetër i sheh si “parime morale që i përkasin të gjithëve për arsyen e thjeshtë se janë qenie njerëzore”, një i tretë i quan “parime morale të drejtësisë dhe barazisë të pranuarra gjerësisht nga shoqëria” etj.

Përkufizimi që sot po pranohet gjithnjë e më shumë, është ai që jepet në botimin e Kombeve të Bashkuara<sup>7</sup>, sipas këtij përkufizimi, të drejtat e njeriut, në përgjithësi, mund të përcaktohen si ato që janë të qënishme në natyrën tonë dhe pa të cilat ne nuk mund të jetojmë si qenie njerëzore. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut na japin mundësinë të zhvillojmë dhe të përdorim tërësisht cilesitë tona njerëzore, inteligjencën tonë, talentet dhe vetëdijen tonë si dhe të kënaqim kërkesat tona njerëzore, inteligjencën tonë, talentet dhe vetëdijen tonë si dhe të kënaqim kërkesat tona shpirtërore dhe nevojat e tjera. Ato janë themelore për kërkesat gjithnjë e më rritje të vazhdueshme të njerezimit për një jetë që të respektojë dhe të mbrojë dinjitetin dhe veprat e çdo qenieje njerëzore.

Nga ky këndvështrim, mohimi i të drejtave të njeriut dhe i liritë themelore nuk përbën vetëm një dramë personale dhe individuale, por krijon kushtet shoqërore dhe politike për hedhjen e farës së dhunës e të konflikteve në nivel kombëtar e më gjerë.

---

7. “ Të drejtat e njeriut- pyetje dhe përgjigje” të vitit 1987.

Për këtë arsye Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, që në fjalinë e saj të parë, shpall që respekti për të drejtat e njeriut dhe për dinjitetin njerëzor “ është themeli i lirisë, i drejtësisë dhe i paqes në botë”.

Sic vihet re dhe në përkufizimin e dhënë *ut supra* të drejtat e njeriut kanë në themel të tyre dinjitetin njerëzor, i cili buron nga vetë thelbi i të qenit njerëz. Për rrjedhim, ky dinjitet duhet pasur parasysh si tek fëmija i porsalindur, që nuk ka kryer ende ndonjë veprim, ashtu edhe tek keqbëresi. Qënia njerëzore ka këtë dinjitet pavarësisht nëse njeriu është i vetëdijshëm për të ose jo.

Ketu është rasti të bejmë dallimin ndërmjet dinjiteti njerëzor dhe dinjiteti personal, të cilin ne e krijojmë dhe e përpunojmë vetë. Dinjiteti personal përcaktohet nga sjellja jonë në raport me normat morale të pranuar gjërisht nga shoqëria: nëse përputhet ose është në kundërshtim me to. Në këtë këndvështrim, të respektosh të drejtat e njeriut, do të thotë të respektosh tek ai qënien njerëzore dhe jo domosdoshmërisht personalitetin e tij.

Ndalimi i diskriminimit është bërë edhe me akte ndërkombëtare duke u aktualizuar shumë më shumë çështja e njohjes dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave, zgjerohet më tepër rrethi i subjekteve dhe krijohen mekanizma për mbrojtjen e shqyrtimin e çënimeve të të drejtave të këtyre grupeve të caktuara. Çështja e njohjes dhe e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut kanë qënë objekt rregullimi në shumë traktate ndërkombëtare. Në shumë prej tyre janë detyruar shtetet që të mos kryejnë çfarëdo veprë të diskriminimit ndaj personave, grupeve të personave ose institucioneve, as të nxisin, të mbrojnë, ndërprerjen ose anulimin e çdo ligji a dispozite që ka për qëllim diskriminimin, si dhe iu është kërkuar ndalimi i diskriminimit me të gjitha mjetet, përfshirë edhe ato ligjorë. Duke përmendur këtu krijimin e mundësisë nga shtetet për personat nën juridiksionin e tyre për një mbrojtje efektive kundër çdo forme të diskriminimit, si dhe të drejtën për kompesim për çfarëdo dëmi që iu është shkaktuar nga një diskriminim i tillë.

Shkelja e të drejtave të njeriut nuk nënkupton thjesht dhe vetëm te penguarit për të realizuar një të drejtë, por nënkupton mohimin e një jete dinjitoze, poshtë së cilës njeriu nuk mund dhe nuk duhet t’ia lejojë vetes të bjerë.

Që këtë del se të drejtat e njeriut janë edhe një praktikë e vecantë njerëzore që synon të realizojë kërkesat minimale të njeriut për një jetë dinjitoze dhe ta mbrojë atë, në mardhëniet e tij të ndërsjellta me pushtetin shtetëror, nga cenimet, poshtërimet, diskriminimet, paragjykimet, qëndrimet çnjerëzore të më të fortit.

- Ka shtete që janë më aktivë në ndihmën që iu japin shtetasve të ndryshëm te shoqërisë. ndërkohë që ka vende të tjera në të cilat shteti me politikën e tij të drejtimit e ka të pamundur të luajë një rol aktiv. Dua ta mbyll këtë punim me një shprehje : Shuma e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe atyre kolektive duhen parashikuar në dokumenta ndërkombëtarë dhe në kushtetuta por më tepër ato duhen rënjosur në mendjen njerëzore s...



## BIBLIOGRAFIA

“ E drejta kushtetuese ”, Luan Omari & Aurela Anastasi, Tiranë

Permbledhjesh aktesh nderkombetare, Arben Puto

“ Jeta Juridike ”, nr. 2, shkurt 2004, Xhezair Zagonjori, “Vendi i se drejtes nderkombetare ne Kushtetuten e R.SH”

“Kushtetuta dhe sistemi i mbrojtjes se te drejtave te njeriut”, botuar ne “ Kushtetuta e re shqiptare sfida e se ardhmes auroatlantike te Shqiperise”, Luiarasi, Tirane 2002, Kristaq Traja.

Sokol Berberi, Krahasimi I nenit 3 te KEDNJ-se me ligjin dhe praktiken shqiptare, ne “ Raportin per studimin e perqasjes se legjislacionit shqiptar me Konventen Europiane te te drejtave te Njeriut”, Tirane, qershor,2003.

International Human Rights Law. Oxford, UK: Hart, 2003.

Philip Alston, Th united Nations and Human Rights: A critical Appraisal. Oxford UK, Clarendon

Jurisprudence of the United Nations Human Rights Committee.

“ Raporti per studimin e perqasjes se legjislacionit shqiptar me Konventen Europiane te te Drejtave te Njeriut ”, Tirane, Qershor 2003.

## AKTE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 10 221 dt. 04.02.2010 “ Per mbrojtjen nga diskriminimi”

-  
KEDNJ - *Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut*

-  
DUDNJ- *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*

KEEFDG- *Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave*

KEEFDR- *Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial*

Kushtetuta e USA.



# Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë



## Ese: Roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në adresimin e çështjeve të diskriminimit gjinor

---

Punoi: Adriana Kalemaj

Tiranë më 20/04/2013

### **Përmbajtja:**

1.Diskriminimi gjinor dhe format e tij.....	11
2.Roli KMD në çështjet e diskriminimit gjinor .....	11
3.Gjetjet kryesore të KMD: Diskriminim gjinor.....	12
4.Konkluzione.....	13
Referenca .....	13

## **1. Diskriminimi gjinor dhe format e tij**

Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinie, që ka për qëllim dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin, në mënyrë të barabartë, nga secila gjini, të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile. Në shoqëri ka individë që besojnë se nuk ekziston asnjë lloj forme diskriminimi ndaj grave, pasi ligjet nuk kanë tendencë të diskriminojnë. Ata nuk marrin në konsideratë situatën de facto, aksesin më të vogël të grave në të gjitha përfitimet. Diskriminimi duhet vështruar në një aspekt më të thellë, si një diskriminim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë. Diskriminimi i drejtpërdrejtë vihet re në ato raste kur shteti dhe ligjet e tij nuk i njeh të drejtën grave për të përfituar në mënyrë të njëjtë me meshkujt. Manifestimi diskriminues i tërthortë evidentohet në të gjitha rastet kur një kusht, në dukje neutral, në të vërtetë rezulton me efekt diskriminues për gratë pavarësisht faktit që nuk ka pasur atë qëllim.

## **2. Roli KMD në çështjet e diskriminimit gjinor**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është krijuar dhe funksionon në zbatim të Ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si institucion i posaçëm që garanton në nivel kombëtar promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve, gjithashtu ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet europiane.

Kompetencat kryesore që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë janë:

1. Të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre;
2. Të kryejnë sondazhe të pavarura në lidhje me diskriminimin;
3. Të publikojnë raporte dhe japin rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin;

KMD është një institucion administrativ, i pavarur, i cili ka edhe disa funksione quasi gjyqësore. Ky funksion duket qartë në kompetencat e tij që lidhen me zgjidhjen e konflikteve dhe ankesave të personave që pretendojnë se janë diskriminuar dhe sidomos në angazhimin e ligjit për të përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen nga Komisioneri për zgjidhjen e ankesave dhe të konflikteve. KMD është autoriteti përgjegjës në Shqipëri, i cili garanton mbrojtjen e subjekteve nga diskriminimi apo nga sjellje që nxit diskriminimin.

Kuadri ligjor mbi të cilin mbështetet organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e Komisionerit bazohet në Kushtetutën e R.Sh, legjisllacionin e brendshëm dhe aktet ndërkombëtare që parashikojnë parimin e mosdiskriminimit.

- Vizioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është:

***“Të jetojmë në një shoqëri ku respektohet parimi i barazisë dhe promovohet barazia e shanseve dhe mundësive” .***

- Pjesëmarrja në Takimin e datës 21.10.2011, kishte për qëllim prezantimin e Raportit

*“Progresi i Grave në Botë: Në kërkim të Drejtësisë”*, raporti i parë kryesor i UN Women që pas themelimit të organizatës në 2010. Kjo paraqitje synonte të nxiste vetëdijen mbi rëndësinë e aksesit të grave në drejtësi. Raporti merr parasysh arritjen e progresit pozitiv por edhe evidentimin e padrejtësive, dhunës dhe pabarazisë në jetën e tyre në shtëpi apo në punë, në politikë apo në jetën publike.

### **3. Gjetjet kryesore të KMD: Diskriminim gjinor**

***Në fushën e punësimit-*** Hendek i gjerë i pagave midis gjinive, skemat në mbështetje të grave që kanë për të shlyer detyrime pune dhe familjare janë të pazhvilluara. Gjithashtu janë shqetësuese ngacmimet seksuale dhe mundësia jo e barabartë në fushën e punësimit për gratë dhe burrat.

***Në fushën e arsimit-*** Duhet rritur masat e posaçme në vend për të siguruar përfaqësimin e grave në nivele të larta drejtuese në institucione arsimore.

***Në fushën shëndetësore-*** Mbetet shqetësim pabarazia në aksesin e grave për kujdes shëndetësor në zonat rurale në krahasim me zonat urbane dhe stigmatizimi e përjashtimi shoqëror i grave me HIV/AIDS.

***Në fusha të ndryshme-*** Kuota gjinore nuk është respektuar në të gjithë vendin në zgjedhjet lokale në Maj 2011.

***Gjate vitit 2011 pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë paraqitur dhe marrë në shqyrtim dy raste që kanë të bëjnë me diskriminimin gjinor:***

#### ***Rasti 1***

***Ankuesja S.C vs. Z.A.K(drejtor ekzekutiv i Fondacionit “Harry Fultz” dhe znj. B.B drejtore e shkollës “Harry Fultz”, ku pretendohet nga ankuesja për diskriminim për shkak të gjinisë.*** Në këtë rast KMD po analizon dhe shqyrton të gjitha provat, shpjegimet, aktet e dokumentacioni i paraqitur nga ana e subjektit ankues dhe palëve kundrejt të cilëve është paraqitur ankesa. Është planifikuar edhe një seance dëgjimore me palët. Aktualisht procedura vazhdon.

#### ***Rasti 2***

***Ankesa e N.Ç. kundër Kryetarit të Bashkisë Kamëz, ku pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë dhe shqetësim seksual në punë.***

Znj. N.C pretendon se I është nënshtruar në mënyrë të përsëritur një sjelljeje diskriminuese nëpërmjet mesazheve në celular, duke u shqetësuar seksualisht në vendin e punës. Ankuesja pretendon se është viktimizuar, si rezultat i ankesave dhe hapave ligjore të ndërmarra prej saj, për shkak të shqetësimit.

Në përgjigje të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme, si dhe po zbaton të gjitha procedurat ligjore për zbardhjen e çështjes.

#### **4. Konkluzione**

KMD duhet të ndërhyjë me veprime ligjore konkrete ndaj institucioneve përkatëse në rastet e diskriminimit gjinor, të rrisë numrin e kontakteve me individët, të verifikojë në mënyrë sistematike, me profesionalizëm dhe në një kohë sa më të shkurtër informacionet që mbartin ankesa të ndryshme, të jetë proaktiv në identifikimin e rasteve të diskriminimit dhe të rrisë transparencën me publikun duke pasuruar faqen *web* të KMD, pika të parashtruara edhe nga Rezoluta e Kryetares së Kuvendit. Diskriminimi që ushtrohet ndaj grave është i papajtueshëm me dinjitetin njerëzor dhe me mirëqenien e familjes e të shoqërisë, nuk i lë gratë të marrin pjesë në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të vendit të tyre .Për të pasur një rezultat të kënaqshëm duhet bërë një punë angazhuese e detajuar dhe e ndjekur hap pas hapi nga institucione si KMD-ja dhe nga e gjithë shoqëria. Prejardhja e diskriminimit në bazë gjinie derivon nga barrierat e së kaluarës, që gjenden në mungesën e aksesit të grave në edukim apo shans trajnimi, ose në mungesën e aksesit të tyre në vendimmarrje në sferën e politikave publike.

#### **Referenca**

Kushtetuta e RSH (1998)

Ligji Nr.9970/ 28.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Ligji Nr.10221/ 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Rezolutë për Vlerësimin e Punës së Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimit për vitin 2012.

Raporti vjetor i komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi, 2011.

Mandro, Arta, Aurela Anastasi, Ermira Shkurti, e Aurela Bozo. *Barazia Gjinore dhe Mosdiskriminimi*. Tiranë: Dajti,2000, 2011.

UNIVERSITETI “MARIN BARLETI”  
FAKULTETI I DREJTËSISË  
VITI I IV

**ROLI I GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJATAT E  
NJERIUT NË ADRESIMIN E ÇËSHTJEVE TË  
DISKRIMINIMIT GJINOR**

ESE  
PUNOI: ZELA BILALAJ

TIRANË 2013

Të drejtat e njeriut janë universale. Ato u përkasin të gjithë individëve dhe duhet të gëzohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë. Pavarësisht kësaj, në shoqëri janë të pranishme sjellje që trajtojnë në mënyrë të diferencuar individë dhe kjo për shkakë nga më të ndryshmet një prej të cilave është edhe përkatësia gjinore. *Çdo trajtim jo i barabartë*

*i një individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme konsiderohet diskriminim i drejtpërdrejtë gjinorë.*

Legjislacioni shqiptar e parashikon në nenin 18 të Kushtetutë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit si një nga parimet themelore por e gjitha kjo do të mbetet thjeshtë një barazi formale nëse nuk do të ndërmerreshin një sërë masash për ta shndërruar këtë në një barazi reale.

Kushtetuta Shqiptare njeh dhe zbaton të drejtën ndërkombëtare si të detyrueshme për të dhe i jep asaj fuqi mbi ligjet kombëtare.<sup>1</sup> Kur bëhet fjalë për kufizimin e të drejtave Kushtetuta i referohet drejtpërdrejtë Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ofron një minimum mbrojtjeje të këtyre të drejtave dhe që vetë shtetet mund të sigurojnë mbrojtje të niveleve më të larta. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 14 të në Protokollin Nr. 7 (neni 5) dhe Protokollin Nr. 12 (neni 1) të saj parashikon parimin e barazisë gjinore si një nga parimet themelore të Këshillit të Evropës dhe të institucioneve të tij. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut si një nga institucionet garantuese të kësaj konvente ka shqyrtuar një sërë çështjesh lidhur me parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.<sup>2</sup>

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në dekadat e para të ekzistencës së saj i ka zbatuar rrallë dispozitat lidhur me barazinë gjinore duke iu referuar më tepër të drejtave substantive dhe shpesh një ankesë për një trajtim të pabarabartë është konsideruar e pamjaftueshme për të përligjur një shqyrtim të veçantë.

Gjykata kur u referohet çështjeve të diskriminimit disa i shqyrton më strikte se të tjerat, duke pranuar disa shkaqe si më bindëse e disa të tjera si “shkaqe të dyshimta”. Fillimisht gjykata nuk dukej se e pranonte konceptin e *diskriminimit të tërthortë*, duke bërë më të pranueshëm *diskriminimin e drejtpërdrejtë*. Por çështjet e kohëve të fundit tregojnë një përjasje të ndryshme nga ana e saj. Gjykata në çështjen *Hoogendijk* ka parashtruar: “Kur një politikë apo masë e përgjithshme ka pasoja paragjyquese disproporcionale ndaj një grupi të caktuar, nuk përjashtohet se kjo gjë mund të shihet si diskriminuese, pavarësisht se ajo nuk synon, apo nuk drejtohet konkretisht ndaj atij grupi”.<sup>3</sup> Gjykata ka pranuar se në nenin 14 të KEDNJ është pranuar jo vetëm diskriminimi formal (trajtim i pabarabartë i çështjeve të barabarta) por edhe diskriminimin substantiv (trajtim i pabarabartë i çështjeve të pabarabarta).<sup>4</sup>

Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut i janë adresuar një sërë çështjesh diskriminimi me bazë seks. Në shumicën e rasteve janë ngritur pretendime për një trajtim të ndryshëm të pajustificuar kundrejt gjinive,

<sup>1</sup> *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 5.*

<sup>2</sup> *Çështjet e barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare*, Udhëzues, Shkolla e Magjistraturës, f. 14-22.

<sup>3</sup> *Hoogendijk v Holandës* (2005) 40 EHRR SE22 at 207.

<sup>4</sup> *Çështjet e barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare*, Udhëzues, Shkolla e Magjistraturës, f. 71.

pavarësisht faktit se burrat dhe gratë janë të ndryshëm si biologjikisht edhe shoqërisht. Në rastet e shqyrtuara nga Gjykata për diskriminimin në bazë seksi ajo është shprehur se: “ Barazia e sekseve është një prej qëllimeve madhore të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës” dhe se Gjykata do t’i trajtojë me shumë kujdes këto çështje në realizimin e këtij qëllimi madhorë. Disa nga pretendimet kryesore kishin të bënin me *role të ndryshme në familje* të grave dhe burrave ku parashtrihen dy situata: parashkrimi i të drejtës për nisjen e procedurave të atësisë dhe mungesa e të drejtës së baballarëve për të marrë leje prindërore ( në disa vende është e lejuar) dhe Gjykata është shprehur se ky është një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm për një trajtim të ndryshëm.<sup>5</sup> Në jurisprudencën e kësaj Gjykate përfshihen dhe një sërë çështjesh të dhunës në familje që përbënin shkelje të nenit 14 të KEDNJ dhe konkludoi se nga rregullat dhe parimet e të Drejtës ndërkombëtare të pranuar nga shumica e shteteve anëtare të KE mosveprimi i shtetit edhe në rast se ishte i paqëllimshëm për të mbrojtur gratë nga dhuna në familja, shkelte të drejtën e grave për mbrojtje të barabartë nga ligji. Gjykata ka trajtuar edhe një sërë çështjesh për sa i përket barazia e grave kundrejt të drejtave fetare si në rastin *Leyla Sahin kundër Turqisë*<sup>6</sup>. Në këtë rast nuk ishim në situatën e diskriminimit gjinor pasi ndalimi i mbajtjes së shamisë në institucionet publike ishte për qëllimin e ligjshëm të sigurimit të neutralitetit dhe ishte i njëjtë si për burrat edhe gratë.

Si përfundim, mund të themi se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është një institucion garantues i të Drejtave të Njeriut të parashikuara nga instrumentet ligjore që parashikojnë këto të drejta në kuadër të Këshillit të Evropës, për pasojë kjo Gjykatë është një garantuese e mirë edhe e parimit të barazisë gjinore. Gjykata në shytimin e çështjeve lidhur me këtë parim luan një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm si një rrugë ligjore më e sigurtë dhe e drejtë por edhe si një plotësuese e vakumeve ligjore të legjislacionit kombëtar të shteteve anëtare të KE, për rastet e diskriminimit gjinor. Vendimet e kësaj Gjykate janë të detyrueshme për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe paraqiten në formë precedenti (*stare decices*), kjo do të thotë që këto shtete nuk mund të japin vendime që bien ndesh me të, përfshirë edhe Shqipëria.

---

<sup>5</sup> Rasmussen v Danimarkës & Petrovic v Austrisë.

<sup>6</sup> Leyla Sahin v Turkey, kërkesa Nr. 44774/98, Vendimi i 29 qershorit 2004.



## **BIBLIOGRAFIA**

*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: QAKAPP, 1998.

*Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut*.

Daci, Jordan. *Të Drejtat e Njeriut*. Tiranë: Erik, 2008.

*Çështjet e barazisë gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare*. Udhëzues. Shkolla e Magjistraturës. 2010.

# ESE ARGUMENTUESE

në kuadër të projektit “Zbatimi i Ligjit nr 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, me mbështetjen e Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci, të Ambasadës së SH.B.A në Tiranë, në prag të 10 Majit, Ditës së Drejtësisë Shqiptare.

**Tema:** “Diskriminimi dhe Kuadri Ligjor në Shqipëri”

**Punoi:** Gëzim SPAHIU

**Materiali i përdorur:** A.Anastasi, “E Drejta Kushtetuese e Krahasuar”

Progres Raportet e Komisionit European për Shqipërinë, vitet 2010-2011

Raporti vjetor i DASH për Shqipërine (2011)

Plani strategjik 2012-2015, për zbatimin e Ligjit “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

Ligji Nr. 9970 “ Për Barazinë Gjinore

Ligji nr 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Wikipedia, etj...

*“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet e në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri –tjetrit me frymë vëllazërimi”.*

Këto fjalë me vlerë universale të sanksionuara për herë të parë në një dispozitë juridike ndërkombëtare, në aktin historik të Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut, shprehin idealin të cilit popujt dhe kombet në mënyrë të pakushtëzuar duhet t’i përmbahen, si dhe pohojnë besimin e thellë tek të Drejtat dhe Liritë themelore të njeriut, njëkohësisht themele të drejtësisë dhe paqes në botë.

Mirëpo respektimi dhe zbatimi me përpikmëri i këtyre të drejtave dhe lirive të njeriut e ka gjenezën e saj në një nga parimet universale më të rëndësishme të botës së lirë demokratike, në Parimin e Barazisë dhe Mosdiskriminimit. Duke filluar që nga Deklarata e Kombeve të Bashkuara, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta Sociale Evropiane e duke vazhduar me një varg aktesh të tjera universale e rajonale, standarte ndërkombëtare, konventa e pakte, ku në themel qëndron Parimi i Barazisë, vihet në pah rëndësia dhe ndjeshmëria për problematikën e diskriminimit dhe mbrojtjen nga të gjithë format në të cilat shfaqet.

Diskriminimi është një “fenomen” i hershëm i njerëzimit, një sëmundje sociale e shfaqur që në fillesat e zhvillimit dhe organizimit kolektiv të njeriut. Edhe zbërthimi etimologjik në gjuhën e vjetër Latine prej nga rrjedh fjala “diskriminim” ( që do të thotë; të ndash, të bësh dallim ) tregon për një problem që i ka rrënjët thellë në mendësinë e njeriut në tërësi.

Një shprehje e humanistit Dalai Lama, në përpjekje për të atakuar diskriminimin thotë : *“Nga pikëpamja e së vërtetës absolute, ajo çfarë ne ndjejmë dhe përjetojmë në përditshmërinë tonë është një iluzion. Nga të gjitha llojet e iluzioneve, ndjesia e diskriminimit mes një qenie njerëzore dhe një tjetre është forma më e keqe që nuk të krijon asgjë veçse një shije të hidhur pakënaqësie të thellë”*.

Megjithatë, trajtimi në një plan juridik i çështjes që ka të bëjë me diskriminimin i ka dhënë dimensione të tjera zgjidhjes së këtij problem sensitiv. Sanksionimi si një parim themelor për funksionimin dhe organizimin e shtetit, në Kushtetutat e të gjithë vendeve të lira e demokratike, është tregues i qartë i reflektimit dhe vullnetit për të eliminuar çdo lloj forme të diferencimit, përjashtimit, dallimit të bazuar në shkaqe si: gjinia, raca, ngjyra, etnia, bindjet politike ose filozofike, gjendja sociale, orientimi seksual ose për çdo shkak tjetër.

Edhe në **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë** ky vullnet pasqyrohet që në Kreun I të Drejtave dhe Lirive themelore, në nenin 18, ku sanksionohet barazia përpara ligjit dhe mbrojtja nga diskriminimi.

Marrja e masave konkrete për forcimin e Parimit të Barazisë, veçanërisht midis burrave dhe grave, si dhe zbatimi efikas i politikave antidiskriminim është një prioritet kyç i vendit tonë, kjo edhe në kuadër të integritetit evropian të Shqipërisë, për aq kohë sa barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe vlerë e përbashkët e vendeve të Bashkimit Evropian.

Shqipëria ka ratifikuar pjesën më të madhe të instrumenteve për të drejtat e njeriut, të cilat janë pjesë e sistemit tonë të brendshëm gjyqësor dhe janë drejtpërdrejtë të zbatueshme. Ndër më të rëndësishmet mund të përmendim:

**Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut** e vitit 1948 që thekson parimin e papranueshmërisë së diskriminimit dhe shpall se të gjithë njerëzit lindin të lirë e të barabartë në dinjitet e në të drejta dhe se secili mund të gëzojë të gjitha të drejtat dhe liritë që përmenden aty, pa asnjë dallim.

**Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut** (dhe Protokollet e saj shtese), e cila, në nenin 14, parashikon “ndalimin e diskriminimit” duke sanksionuar se “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”.

**Karta Sociale Evropiane** që ka sanksionuar parimin e barazisë përpara ligjit dhe parimin e mosdiskriminimit.

**Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore**, i ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991 që sanksionon detyrimin për shtetet palë për të garantuar që të drejtat e shpallura në këtë Pakt, të ushtrohen pa kurrfarë diskriminimi .

**Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas**, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1994 që parashikon mbrojtjen e grave nga diskriminimi nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshejtimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave si detyrimin për marrjen e masave të përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t'i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme si: në jetën politike dhe publike të vendit; në fushën e arsimit; në fushën e punësimit; për të parandaluar diskriminimin ndaj grave për shkaqe martesore apo amësie, dhe për të siguruar të drejtën e tyre efektive për punë; në fushën e kujdesit shëndetësor për t'u siguruar, mundësitë për të përfutur shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit familjar; në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare.

Përsa i përket kuadrit të brendshëm ligjor, legjislacioni shqiptar në fushën kundër diskriminimit parashikohet në një tërësi aktesh juridike që në mënyrë të sintetizuar vijojnë si më poshtë:

Me rëndësi të veçantë qëndron miratimi në vitin 2008 i **Ligjit Nr. 9970 “Për Barazinë Gjinore”** i cili rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore;

**Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”**, i cili synon parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.

Një zhvillimi thelbësor përbën miratimi i **Ligjit nr 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”** një ligj organik i hartuar me konsulencën e gjerë të ekspertizës vendase e ndërkombëtare si dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile, mbi bazën e të cilit sigurohet mbrojtja nga diskriminimi dhe respektimi i parimit të barazisë në lidhje me një liste joshteruese shkaqesh.

**Ligji nr 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”**, i ndryshuar, i cili në nenin 9 “Ndalimi i Diskriminimit” parashikon ndalimin e çdo lloji diskriminimi në fushën e marrjes në punë, që cënon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim. Në kontekstin e antidiskriminimit, rëndësi marrin edhe parashikimet e neneve 8 dhe 115 të këtij ligji mbi ndalimin e punës së detyruar dhe mbi barazinë në shpërblime midis sekseve të ndryshme.

Zhvillime të rëndësishme janë bërë në lidhje me zbatimin e politikave antidiskriminim, ku ngritja e një organi të barazisë, e **Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, ka vitalizuar ndjeshëm reagimin publik në lidhje me problemet që lidhen me diskriminimin.

Megjithatë, barazia midis burrave dhe grave në vendin tonë mbetet një çështje komplekse. Faktorët socialë, kulturorë, ekonomikë e historikë ndikojnë në krijimin e pengesave për zbatimin efikas të tërësisë së akteve ligjore të përmendura më lart. Vendimmarrja në jetën publike vazhdon të ketë një deficensë dhe një numër të vogël të grave. Dhuna në familje vazhdon të jetë e përhapur dhe mbrojtja e grave ndaj të gjithë formave të dhunës kërkon një mobilizim të mëtejshëm të organeve kompetente. Femrat vazhdojnë të diskriminohen në kuptimin e aksesit në punësim, arsim dhe në pozicionet drejtuese të administratës publike.

Në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale kërkohet një alokim më i madh i burimeve të duhura për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe funksionimin me kapacitete më të zgjeruara të Komisionerit të parashikuar nga ky ligj. Konkretisht prioritetet për t'u realizuar konsistojnë në zbatimin e objektivave strategjikë të mëposhtëm si:

a) Organizimi i përshtatshëm institucional dhe forcimi i institucionit përmes rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit, me qëllim final rritjen e efikasitetit të Zyrës së KMD për marrjen, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të subjekteve që pretendojnë diskriminim;

b) Zhvillimi dhe përmirësimi i legjislacionit të brendshëm në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e antidiskriminimit;

c) Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis KMD dhe gjykatave dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera publike, donatorët, shoqërinë civile dhe median, në funksion të garantimit të zbatimit efektiv të ligjit.

d) Angazhimi i posaçëm i KMD në planifikimin dhe zbatimin e masave konkrete për ndërhyrjen në kurrikulat shkollore në funksion të shmangies së elementëve diskriminues dhe përfshirjes së koncepteve antidiskriminim.

Në këtë kuadër realizimi me përgjegjshmëri i objektivave të mësipërm e përball fenomenin e diskriminimit me një mentalitet të ri e bashkëkohor duke e kthyer në një prioritet moral e politik të shtetit në tërësi.

Nga parashtrimi i gjithë kësaj tabloje të gjendjes aktuale në vendin tonë, ajo çfarë më së shumti kërkohet është ndërgjegjësimi qoftë edhe për një fakt të thjeshtë; se gruaja mbulon sot më shumë se gjysmën e popullsisë totale në Shqipëri por edhe në botë dhe kjo do të thotë se trajtimi i pabarabartë midis burrave dhe grave sjell praktikisht privim nga shanset e ofruara të shumicës së popullsisë së përgjithshme. Ka ardhur koha që të kuptojmë realisht se nuk ka dallime midis burrit dhe gruas, se të gjithë duhet të konvergojmë forcat për të çuar përpara potencialin dhe kapacitetin që zotërojmë si qenie njerëzore. *Një grua është gjithashtu një qenie njerëzore. Ajo nuk është më e mirë, më e mençur, më e fortë, më kreative apo më e përgjegjshme se një burë. Por as nuk është më pak.* Kjo do të thotë se barazia ekziston.

Prandaj, në mbyllje dëshiroj të citoj një shprehje me një mesazh universal të A. Anjshtajn: *“Jeta është si ngasësh një mjet me dy rrota. Për të ruajtur ekuilibrin duhet të vazhdojmë përpara”*.

# Ese

**Përgatiti Klaudia Biba  
Fakulteti i Drejtësis, UT**

# ROLI I GJYKATËS SË LARTË TË SHTETEVE TË BASHKUARA NË ADRESIMIN E ÇËSHTJEVE TË DISKRIMINIMIT GJINOR.

Diskriminimi gjinor përbën trajtimin e padrejtë të një personi për shkak të seksit të tij. Historikisht femrat kanë qenë të diskriminuara duke u bazuar ekskluzivisht në gjininë e tyre. Në Shtetet e Bashkuara, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë në konsideratë përfshirjen e grave nën garancinë e Amendamentit të katërmbëdhjetë ("equal protection of the laws" - për mbrojtje të barabartë nga ligjet), deri në vitin 1970. Ndërkohë, që nga fundi i shekullit XX, ligje për ndalimin e diskriminimit gjinor janë duke u aplikuar edhe për mbrojtjen e meshkujve.

Në çështjet lidhur me diskriminimin gjinor, Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara jo vetëm që ka përcaktuar zbatueshmërinë e garancisë për mbrojtje të barabartë juridike në nivel kushtetues dhe në statutet federale, por, është përpjekur të gjeje mekanizma konkret për eliminimin e diskriminimit gjinor. Në vijim të këtij punimi paraqiten sfidat bashkohore të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara (Gjykata) në çështjet e diskriminimit gjinor; bazuar në mbrojtjen e barabartë garantuar në Amendamentin 14 dhe 5, si dhe veçanërisht në Pjesën e shtatë të Aktit të Drejtave Civile 1964, mbi ndalimin e diskriminimit në punësim.

## Klasifikimet gjinore

Megjithëse Amendamenti katërmbëdhjetë kërkon mbrojtje të barabartë, ai nuk përjashton klasifikimin e individëve. Gjykata ka vërejtur se "Kushtetuta nuk kërkon që subjekte që janë të ndryshëm në fakt apo opinion të trajtohen në ligj si të ishin të njëjtë"<sup>7</sup>

Por një klasifikim nuk do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën përveç nëse ai është i karakterizuar nga diskriminimi. Dhe, për këtë, Gjykata ka miratuar tre nivele të shqyrtimit që vlerësojnë praninë e diskriminimit:

1. Shqyrtimi i rreptë;
2. Shqyrtimi i ndërmjetëm;
3. Shqyrtimi i bazuar, racional.

Zakonisht klasifikimet gjinore janë subjekt i shqyrtimit të ndërmjetëm.

Shqyrtimi i ndërmjetëm për klasifikimet gjinore u aplikua nga Gjykata për herë të parë më 1976 në çështjen *Craig kundër Boren*.

Gjykata e shpalli antikushtetues një Statut të shtetit të Oklahomas që ndalonte shitjen e berrës "të pa intoksifikuar 3.2% ", tek meshkujt nën moshën 21 vjeç dhe femrat nën moshën 18 vjeç. Edhe pse Gjykata u pajtua me gjendjen e argumentit se mbrojtja e shëndetit publik dhe sigurisë është një interes i rëndësishëm qeveritar, ajo konstatoi se klasifikimi gjinor në këtë Statut nuk ishte lidhur thelbësisht në arritjen e këtij qëllimi. Pavarësisht provave statistikore të paraqitura nga ana e shtetit, ku tregohet se meshkujt të moshës 18-21 vjeçare përbënin numrin më të madh të të dëmtuarve nga aksidentet rrugore për shkak të gjendjes së dëhur, Gjykata vendosi se nuk mund të lejoheshin krijimet e klasifikimeve të tilla gjinore.

Në një rast tjetër, SHBA kundër Virginia, Gjykata shpalli antikushtetues përjashtimin e femrave nga Instituti Ushtarak i Virxhinias (VMI). Instituti ushtarak i Virxhinias ishte e vetmja shkollë publike vetëm për meshkuj. SHBA paditën Virxhinian dhe VMI-në duke argumentuar se politika e pranimit vetëm për meshkuj në VMI

---

<sup>7</sup> (Tigner k. Texas)

shkelte nenin e Mbrojtjes së Barabartë të Amendamentit Katërmbëdhjetë. Si përgjigje Virxhinia propozoi një program paralel për femrat: Institutin e Virxhinias të vajzave për lidhshëm (VWIL).<sup>8</sup> Gjykata i kërkoi shtetit të Virxhinias një "justifikim jashtëzakonisht bindës" për veprimet e tij. Barra e arsytimit i kërkohet dhe i takon tërësisht shtetit.

Nga praktika e gjykatës së Lartë të SHBA lidhur me çështjet e krijimit të klasifikimeve gjinore, edhe në raste të tjera si *Califano k. Goldfarb, J.E.B. k. Alabama*, etj, Gjykata ka interpretuar se: "Shtetet duhet të tregojnë të paktën se klasifikimet gjinore u shërbejnë objektivave të rëndësishme qeveritare dhe se mjetet diskriminuese të përdorura janë të lidhura kryesisht me arritjen e këtyre objektivave. Justifikimi duhet të jetë i saktë, jo i hamendësuar apo i trilluar në mbështetje të procesit gjyqësor. Kjo nuk duhet të mbështetet në përgjithësime të gjëra rreth talenteve të ndryshme, aftësive apo preferencave të meshkujve dhe femrave".<sup>9</sup>

### **Diferencimi gjinor në kuadrin e fitimit të shtetësisë**

I një rëndësie të veçantë është edhe kontributi që ka dhënë Gjykata e Lartë në lidhje me rastet që përfshijnë diskriminimin gjinor në kuadrin e fitimit të shtetësisë.

Në çështjen, *Miller kundër Albright*, Gjykata e konsideroi një sfidë nenin 309 të Aktit të Emigracionit dhe Kombësisë. Kërkuesi, fëmija i një babai amerikan dhe një nënë filipinase, argumentonte se § 309 impononte kërkesa shtesë për krijimin e shtetësisë amerikane kur një fëmijë është me atësi shtetas amerikan. Për fëmijët e lindur nga një nënë shtetase amerikane dhe një baba i huaj shtetësia fitohej që në lindje. Ndërsa për fëmijët e lindur nga një baba shtetas amerikan dhe nga një nënë e huaj shtetësia nuk fitohej derisa babai ose fëmija të merrte hapa afirmativë për të konfirmuar marrëdhënien e tyre (pasi fëmija të kishte mbushur moshën 18 vjeç). Në rastin në fjalë babai i kërkueses nuk kishte mundësi të konfirmonte lidhjen atërore derisa fëmija të mbushte moshën 18 vjeçare. Kështu që aplikimi për fitimin e shtetësisë nga kërkuesja, ishte refuzuar.

Çështja prodhoi pesë mendime të ndryshme. Megjithëse të gjashtë gjyqtarët ranë dakort që ankesa e kërkueses duhej të shkarkohej, ato dhanë arsye të ndryshme për këtë konkluzion. Gjyqtarët Stevens dhe Rehnquist pretendonin se ankesës së kërkueses i mungonte merita, duke pohuar se dallimi § 309 e në mes të fëmijëve "legjitimë" të nënave shtetase amerikane dhe fëmijëve "legjitimë" të etërve shtetas amerikanë është i lejueshëm nën një shqyrtim të rreptë për shkak se kjo është *jashtëzakonisht e arsyeshme dhe e justifikuar nga politikat të rëndësishme qeveritare*.

Gjyqtarët O'Connor dhe Kennedy pretendonin, megjithatë, se dallimi mund ti rezistojë vetëm një shqyrtimi të bazuar racional dhe nuk mund të kënaqë llojin e shqyrtimit të paraqitur nga gjyqtari Stevens. Duke lënë mënjane çështjen e kushtetutshmërisë së § 309, gjyqtarët O'Connor dhe Kennedy besonin se kërkueses i mungonte pozita, madje edhe e nevojshme, për të ndjekur pretendimin e saj. Së fundi, gjyqtarët Scalia dhe Thomas pretendonin se ankesa e kërkueses duhet hedhur poshtë për shkak se Gjykatës i mungon kompetenca për shtetësinë. Duke pranuar se Kongresi ka autoritetin ekskluziv për të dhënë shtetësinë, Gjyqtarët Scalia dhe Thomas besonin se nuk kishte nevojë për të adresuar kushtetutshmërinë e § 309. Gjyqtarët Ginsburg, Breyer, dhe Souter paraqiten gjithashtu opinionet e tyre.

---

<sup>8</sup> *Të Drejtat Kushtetuese në interpretimin e Gjykatës së lartë të SHBA-së*, fq27

<sup>9</sup> *Po aty*, fq 30



Në opinionet e tyre të veçanta, secili gjyqtar argumentonte se § 309 i adresojë stereotipave gjinorë. § 309 mbështetet në përgjithësimet rreth burrave dhe grave dhe lidhjet që ata mbajnë me fëmijët e tyre. Kështu që, kërkesat shtesë të § 309 janë të përshtatshme për etërit, por të panevojshme për nënat.

## **Diskriminimi në punë dhe ngacmimet seksuale**

Gjykata ka zhvilluar dy modele kryesore për të provuar pretendimet mbi diskriminimin në punësim: Trajtimi i ndryshëm dhe ndikimi i ndryshëm (*Disparate Treatment and Disparate Impact*)<sup>10</sup>.

Modeli i "Trajtimit të ndryshëm", fokusohet në qëllimin e punëdhënësit për të diskriminuar. Ndërsa, modeli i "Ndikimit të ndryshëm" është i fokusuar në efektet negative të praktikave të punëdhënësit mbi një klasë të mbrojtur.<sup>11</sup> Në të dy modelet, analiza përfshin një sistem të përmbysjes së barrës së provës. Për shembull, punëdhënësi mund të paraqesë prova që tregojnë se veprimet e tij janë të justifikuara për shkak të nevojave të biznesit. Ndërkohë, paditësi duhet të vërtetojë që pohimi i punëdhënësit mbi arsyet legjitime dhe jo diskriminuese të veprimeve të tij, ishte një pretekst për të errësuar diskriminimin e paligjshëm.

Në rastin Harris kundër Forklift Systems, Inc, Gjykata kërkoi të përcaktojë kur një vend pune ishte mjaftueshëm "armiqësor" për qëllimet e mbajtjes së një kërkesë nën Titullin VII të Aktit të Drejtave Civile 1964. Kërkuesja, një menaxhere femër në një kompani pajisjesh me qira, pohoi se presidenti i kompanisë kishte krijuar një ambient armiqësor duke përsëritur fyerje për shkak të gjinisë së saj dhe duke e bërë atë objekt të padëshiruar. Gjykata ka konstatuar se një punonjës nuk duhet të pësojë vetëm dëmtime fizike që të ngrejë një pretendim për mjedis armiqësor sipas Titullit VII: "Për aq kohë sa mjedisi, arsyeshëm, të perceptohet si armiqësor apo abuziv ... nuk ka nevojë që ai gjithashtu të jetë psikologjikisht i dëmshëm.

Gjykata ka identifikuar katër faktorët që duhet të merren në konsideratë për të përcaktuar nëse ekziston një mjedis armiqësor:

- (1) frekuenca e sjelljes diskriminuese;
- (2) ashpërsisë e një sjellje të tillë;
- (3) nëse sjellja është fizikisht e rrezikshme ose degraduese; dhe
- (4) nëse sjellja ndërhyr në mënyrë të paarsyeshme në performancën e punës së punonjësit.

Edhe pse Gjykata i deklaroi këto faktorë si identifikues të një mjedisi armiqësor, ajo theksoi se asnjë faktor më vete nuk është përcaktues.

Kohët e fundit, Gjykata e Lartë pranoi të shqyrtojë çështjen *Crawford kundër Metropolitan Government of Nashville and Davidson County*, një rast në të cilën paditësjja pretendonte se pjesëmarrja e saj në një hetim kundër ngacmimeve seksuale të mbikëqyrësit të saj rezultoi në pushimin e saj nga puna. Edhe pse paditësjja kishte bashkëpunuar në hetimin dhe dëshmoi lidhur me komentet eksplicite dhe veprimet e bëra nga bos i saj, fakti që ajo nuk e kishte paraqitur ankesën për ngacmim seksual apo akuza të tjera me anë të Komisionit për Mundësi të Barabarta Punësimi (EEOC), e ka udhëhequr Gjykatë të vendosë që ajo nuk ishte e mbuluar sipas dispozitës së Pjesës VII, për hakmarrje.

Duke përfaqësuar shumicën, gjykatësi Souter përcaktoi dy aktivitetet që mbron Titulli VII duke thënë se seksionin 704 (a) "bën të paligjshme për një punëdhënësi që të diskriminojë kundër çdo punonjësi ... që (1) ka kundërshtuar ndonjë praktikë të paligjshme të punësimin nga ky Nënkapitull ose (2) ka bërë një akuzë, dëshmi,

<sup>10</sup> WikiLeaks Document Release; <http://wikileaks.org/wiki/CRS-RL30253>

<sup>11</sup> Sex Discrimination and the United States Supreme Court - Jody Feder

ndihmuar, ose ka marrë pjesë në ndonjë mënyrë në një hetim, procedim të punëdhënësit”<sup>12</sup>. Por, në rastin konkret kërkuesja nuk e kishte iniciuar ankesën e saj përpara se hetimi të kryhej dhe se hetimi i brendshëm nuk ishte kryer në pajtim me një akuzë me anë të EEOC. Në këto kushte Crawford nuk përfshihej në klauzolën e përfshirjes në hetim. Një punonjës duhet të kundërshtojë praktikat diskriminuese të punëdhënësit të tij, jo vetëm atëherë kur nxitet nga subjekte të jashtëm, por në çdo kohë.

## **Të bërit legjislacionin efektiv**

Jurisprudence e Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara duhet të na shërbejë për të rritur efikasitetin e rezultateve të përdorimit të ligjeve me karakter antidiskriminues. Siç është shprehur dhe Gjykata: “vendimet në këtë fushë duhet të promovojnë efikasitetin e legjislacionit”.

Ligjet ekzistuese antidiskriminues përmbajnë një numër dispozitash të dizenuara për të lehtësuar çështjet gjyqësore, të tilla si mbrojtje e ankuesve nga viktimizimi ose dispozita për një ndryshim në barrën e provës, ku ankuesi/ja konstaton faktet nga të cilat mund të supozohet se ka ndodhur diskriminimi. Megjithatë hapa shtesë janë të nevojshëm për të promovuar efikasitetin e legjislacionit.

Mungesa e dukshme e ankesave dhe veprimeve ligjore nga viktimat e diskriminimit gjinor mund të jetë kryesisht një tregues i mungesës së legjislacionit përkatës specifik, apo të mungesës së ndërgjegjësimit të disponueshmërisë së mjeteve juridike, apo e vullnetit të pamjaftueshëm të viktimave për të ndjekur ligjërisht çështjet e tyre.

Dispozitat ekzistuese kërkojnë sanksione të cilat janë “efektive, proporcionale dhe bindëse”. Megjithatë, zbatimi këtyre dispozitave është shumë i ndryshueshëm. Në lidhje me mjetet juridike, duhet:

1. Ligji shprehimisht të ndalojë vendosjen e një kufiri maksimal të kompensimit financiar, në rastet e diskriminimit;
2. Të përfshihet një dispozitë që i detyron organet gjyqësore mundësinë e rekursit të përparësisë së procedurave gjyqësore, kur urgjenca është e nevojshme;
3. Përfshirjen e dispozitave për të lejuar kompensim për dëmin jopasuror për viktimat e diskriminimit.

Nëse ligji është hartuar që të jetë plotësisht efektiv në praktikë, atëherë duhet të jepet mundësia që ankesat për diskriminim gjinor të sillen, madje edhe në mungesë të një ankuesi individual. Kjo mund të arrihet në dy mënyra: 1) paraqitja e kërkesave të tilla nga organe të pavarura shtetërore, ose 2) paraqitja e kërkesave të tilla nga organizata jofitimprurëse që përfshijnë një fushë të tillë.

Së fundi, mbetet të përmend sensibilizimin e qytetarëve, sidomos asaj pjese që është më e prekur nga ky fenomen, nëpërmjet fushatave për njohjen dhe aplikimin e ligjeve antidiskriminues.

Megjithatë, edhe me procedurat dhe mjetet juridike efektive, shumë individë do të pengohen nga dalja në gjyq për shkak të kostove financiare dhe emocionale që kjo përfshin, ose thjesht për shkak të mungesës së familjaritetit me të drejtat e tyre ligjore.

## **BIBLOGRAFIA**

---

<sup>12</sup> Title VII of the Civil Rights Act of 1964

- U.S. Constitution. Amendment. V; U.S. Constitution Amendment. XIV, § 1.
- Title VII of the Civil Rights Act of 1964
- Të Drejtat Kushtetuese në interpretimin e Gjykatës së lartë të SHBA- Punim i Qendrës për Nisma ligjore Qytetare, Tiranë 2012
- Sex Discrimination and the United States Supreme Court - Jody Feder
- United States Supreme Court cases; <http://www.supremecourt.gov/>
- WikiLeaks Document Release; <http://wikileaks.org/wiki/CRS-RL30253>